

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**PROGRAMI- SHKENCA E USHQIMIT**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**Ndikimi i riplehimit pranveror në vetitë agronomike dhe  
cilësore të grurit të kultivuar në regjionin e Anamoravës**

Mentori/ja:

Prof. Asoc. Dr. Salih Salihu

Kandidati/ja:

Blerta Lladrovci

*Prishtinë, Shtator 2023*

## ***ABSTRAKTI***

Gruri është njëri prej drithërave më të përdorura dhe duke qenë i tillë kërkesa për të është shumë e madhe. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të evidentohet ndikimi i plehrave në proteinat e grurit të llojit Pobeda, i cili është mbjellur në tokë të paplehëruar paraprakisht. Plehurat që janë përdorur janë: Urea dhe Nag, si dhe kombinimi i të dyjave. Eksperimenti është realizuar kështu: Toka është ndarë në disa parcela të cilave iu është referuar si parcela A, B, C dhe D në të cilat gruri i mbjellur është trajtuar me lloje dhe sasi të ndryshme të plehut. Mostrat nga këto parcela janë analizuar për parametrat agronomikë dhe cilësorë të tyre. Rezultatet kanë treguar se gjatësia e trupit dhe e kallirit tregon për zhvillimin dhe produktivitetin që gruri do të jap për atë sezonë të të korrurave. Në parcelën D ku është aplikuar 400 kg Nag, gruri është rritur më së shumti me mesataren 80 cm, pastaj në parcelën B me pleh Urea mesatarja arrin 79 cm, ndërsa në parcelën A ku nuk është aplikuar pleh rezultati është 65.33 cm, njëkohësisht më e ulta. Gjatësinë më të madhe të kallirit jep parcela B. Sa i përket rendimentit, rezultat më të lartë ka treguar parcela C (e trajtuar me Nag dhe Ure) me ndryshime të vogla tek parcelat ku është aplikuar lloj tjetër i plehut.

Duke marrur parasysh konsumimin e produkteve të grurit, përpos analizave agronomike, rëndësi të madhe ka edhe cilësia e miellit. Përmes numrit rënës të Hagbergut shihet se kultivari Pobeda ka dhënë miell i cili bën pjesë tek grupi me numër rënës 200-300, i cili jep brum të dëshirueshëm për pjekurina. Gjithashtu, përmes analizës NIRS është parë se mielli i përfituar nga 4 parcelat del se përmban vlerat e dëshirueshme të hirit, proteinave, fibrave dhe amidonit për konsumim.

Nga mielli i grurit si produkt final marrim bukën e cila është mjaft e konsumuar në vendin tonë, prandaj për këtë punim janë bërë edhe disa analiza të bukës. Sipas analizave buka ka marrë ngjyrë dhe porozitet të dëshirueshëm nga mielli i parcelave C dhe D.

Ky hulumtim ka natyrë sasiore dhe dizajni i tij është eksperimentativ. Të dhënat janë analizuar në laboratorin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës.

**Fjalët kyqe:** *gruri Pobeda, Nag, Urea, plehërimi, proteina*

## ***ABSTRACT***

Wheat is one of the most widely used cereals and being such, the demand for it is very high. The purpose of this research was to identify the influence of fertilizers on the proteins of Pobeda type of wheat, which was planted on unfertilized soil. Fertilizers that have been used are: Urea and Nag, as well as the combination of both. The experiment was carried out as follows: The land was divided into several plots referred to as plots A, B, C and D in which the planted wheat was treated with different types and amounts of fertilizer. The samples from these plots were analyzed for their agronomic and quality parameters. The results showed that the length of the body and the cob indicate the development and productivity that the wheat will give for that crop season. In plot D where 400 kg of NAG was applied, wheat grew the most with an average of 80 cm, then in plot B the average reached 79 cm, while in plot A where no fertilizer was applied the result was 65.33 cm, at the same time the lowest. Plot B with Urea fertilizer gives the longest length of the cob. Regarding the yield, the highest result was shown by plot C with small changes in the plots where another type of fertilizer was applied.

In addition to agronomic analyses, taking into account the consumption of wheat products, the quality of the flour is also of great importance, where through the falling number of Hagberg it can be seen that the Pobeda cultivar has produced flour that belongs to the group with a falling number of 200-300, which gives desirable dough for pastries. Also, through the NIRS analysis, it was seen that the flour obtained from the 4 plots appears to contain the desirable values of ash, protein, fiber and starch for consumption.

From wheat flour as a final product, we get bread, which is quite consumed in our country, therefore, for this research, some analyzes of bread have been made. According to the analyses, the bread has acquired a desirable color and porosity from the flour of plots C and D.

This research has a quantitative nature, the design of which is experimental, the data were analyzed in the laboratory of the Faculty of Agriculture and Veterinary Medicine at the University of Prishtina.

**Key words:** *wheat Pobeda, Nag, fertilizer, protein, Urea*